

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr.28, datë 28 04. 2004

Për

“Miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes ”

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, në bazë të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të miratojë uljen me 0.25 pikë përqindjeje të normës të interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (repo dhe repo të anasjellta). Norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes ulet nga 6.50 për qind, në 6.25 për qind.
2. Ngarkohet Departamenti i Politikës Monetare dhe i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI
Ylli MEMISHA**

**KRYETARI
Shkëlqim CANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

Nr.29, datë 28 04. 2004

Për

“Disa ndryshime në rregulloren “Mbi kredinë njëditore” “

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” neni 43, shkronja c,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi kredinë njëditore” të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.08, datë 07.02.2001 të bëhen ndryshimet si më poshtë :

Neni 3, pika 2 të zëvendësohet me fjalinë “Banka e Shqipërisë akordon kredi njëditore automatike për bankat e nivelit të dytë për rastet e parashikuara në rregulloren “Mbi kredinë brënda ditës”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.20, datë 24.03.2004.

Neni 4, të zëvendësohet me fjalinë “Për garantimin e kredisë njëditore shërbejnë rregullat dhe procedurat e përcaktuara në rregulloren " Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë", miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.107, datë 24.12.2003.”

2. Ngarkohet Departamenti Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
Ylli MEMISHA

KRYETARI
Shkëlqim CANI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr.30, datë 28. 04. 2004

**Për
“Dokumentin e “Politikës Operative të Mbikëqyrjes”.”**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, në bazë të nenit 12, gërma “a” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”

V e n d o s i :

1. Të miratojë në parim dokumentin e “Politikës Operative të Mbikëqyrjes”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun në Bankën e Shqipërisë për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI
Ylli MEMISHA**

**KRYETARI
Shkëlqim CANI**

BANKA E SHQIPËRISË KËSHILLI MBIKËQYRËS

POLITIKA OPERATIVE E MBIKËQYRJES

Hyrje

Politika Operative e Mbikëqyrjes (POM), është një dokument i cili përcakton kriteret e një mbikëqyrjeje të vazhdueshme të orientuar sipas rrezikut, për të gjitha institucionet që janë subjekt i licencimit nga Banka e Shqipërisë.

Politika synon të tregojë orientimin e procesit mbikëqyrës drejt rrezikut të aktivitetit bankar. Kjo do të thotë, që burimet dhe kapacitetet mbikëqyrëse të drejtohen drejt monitorimit të bankave që paraqesin një rrezik më të lartë, duke realizuar në këtë mënyrë një përdorim më efektiv të tyre. Në këtë dokument, janë përcaktuar disa ngjarje të cilat minimalisht duhet të ndodhin gjatë një cikli mbikëqyrës, për ta shndërruar funksionin mbikëqyrës në një proces të vazhdueshëm.

Dokumenti përmban edhe koncepte të veprimeve korrektuese dhe penalizuese që ndërmerr Banka e Shqipërisë gjatë procesit mbikëqyrës, duke synuar të rrisë transparencën rreth kushteve të përdorimit të tyre.

Përveç mënyrës së kryerjes së procesit të mbikëqyrjes në një kuadër të përgjithshëm, në këtë politikë do të përcaktohen disa element që synojnë të saktësojnë marrëdhëniet midis punonjësve të Departamentit të Mbikëqyrjes gjatë këtij procesi.

Dokumenti përmban edhe disa parime mbi të cilat ndërtohen linjat e komunikimit midis vetë departamentit, midis departamentit dhe njësive të tjera të strukturës së Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe administratorët dhe Këshillin Mbikëqyrës, si edhe komunikimin midis departamentit dhe institucioneve të tjera.

Gjatë shtjellimit të kësaj politike do t'i referohemi kryesisht bankave, duke nënkuptuar sipas rastit, degët e bankave të huaja, degët e bankave shqiptare jashtë vendit si edhe të gjitha institucionet e tjera jobanka, të cilat kanë marrë një licencë veprimi nga Banka e Shqipërisë.

Përmbajtja:

I. ELEMENTE TË MBIKËQYRJES

- a. Parimet e mbikëqyrjes
- b. Instrumentet e mbikëqyrjes
- c. Profili i rrezikut
- d. Cikli i Mbikëqyrjes
 - i. Cikli normal
 - ii. Cikli i përforcuar
 - iii. Cikli intensiv
- iv. Veprimet penalizuese
- v. Administrimi/Kujdestaria dhe likuidimi

II. PROCEDURA TË ZBATIMIT TË FUNKSIONIT MBIKËQYRËS

- a. Kuadri rregullativ dhe licencues
 - i. Parimet
 - ii. Rishikimi
 - iii. Publikimi
- b. Mbikëqyrja nga jashtë
 - i. Funkzioni
 - ii. Verifikimi i cilësisë së të dhënave
 - iii. Shpërndarja e konkluzioneve
 - iv. Integrimi
 - v. Produktet
- c. Mbikëqyrja në vend
 - i. Llojet e inspektimeve
 - ii. Fazat e procesit të inspektimit
 1. përgatitja për inspektim
 2. kryerja e inspektimit
 3. hartimi i raportit
 4. ndjekja e rekomandimeve
 - d. Strategjitë
 - i. Qëllimi
 - ii. Struktura
 - iii. Përmbajtja
 - iv. Ndryshimi dhe përgjegjësitë
 - e. Baza elektronike e të dhënave

III. KOMUNIKIMI

- a. Komunikimi brenda Departamentit të Mbikëqyrjes
- b. Komunikimi me njësitë e tjera të Bankës së Shqipërisë
- c. Komunikimi jashtë Bankës së Shqipërisë

Aneks 1:

I. ELEMENTE TË MBIKËQYRJES

a) Parimet e Mbikëqyrjes

Mbikëqyrja ndërtohet mbi këto parime:

- vazhdueshmëria, duke kuptuar konceptimin e këtij funksioni si një proces, i cili synon monitorimin e bankës në të gjithë gjatësinë e ciklit të mbikëqyrjes nëpërmjet instrumenteve mbikëqyrëse dhe vendosjes së një raporti të drejtë komunikimi dhe bashkëpunimi me bankën dhe me institucione të tjera, që ndihmojnë në funksionin mbikëqyrës;
- orientimi sipas profilit të rrezikut të bankës, duke kuptuar rëndësinë që ky proces të jetë i ndërtuar mbi bazën e përparësive që lidhen me llojin e aktivitetit të bankës, me madhësinë dhe me peshën që ajo zotëron në sistem, me karakteristikat e rrezikut të aktivitetit të saj si edhe mbi bazën e shfrytëzimit sa më efektiv të burimeve në dispozicion;
- konsolidimi, duke kuptuar që mbikëqyrja e një banke shtrihet edhe në aktivitetet ose personat e lidhur me bankën. Aty ku është e mbështetur ligjërisht mbikëqyrja e konsoliduar zhvillohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet mbikëqyrëse të tyre. Në rastin e fundit, ky bashkëpunim institucionalizohet në formën e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit ;
- verifikueshmëria, e cila kupton përputhshmërinë e aktivitetit të bankës me kuadrin ligjor dhe atë rregullativ mbikëqyrës, nëpërmjet inspektimit të aktivitetit të bankës dhe të transaksioneve që ajo ka kryer, nëpërmjet inspektimit të procedurave dhe të politikave të saja etj.;
- objektiviteti, që kupton se ai është një proces objektiv dhe i pavarur, i ndershëm dhe i paanshëm, si edhe i mbështetur në kuadrin legjislativ dhe rregullativ vendas;
- përputhshmëria me standardet më të mira ndërkombëtare, duke kuptuar rëndësinë që procesi mbikëqyrës të konceptohet dhe të realizohet në përputhje me parimet e Bazelit, si institucioni drejtues në përcaktimin e metodologjisë së mbikëqyrjes.

Procesi i mbikëqyrjes kryhet nga Departamenti i Mbikëqyrjes. Në rastin e degëve të bankave të huaja që operojnë në Republikën e Shqipërisë, procesi i mbikëqyrjes synohet të realizohet në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës të vendit ku banka ka selinë e saj qendrore. I njëjti bashkëpunim, ofrohet edhe për autoritetet mbikëqyrëse të vendit të huaj ku një bankë, me seli qendrore në Shqipëri, ka degën(t) e saj. Për këtë qëllim, Departamenti i Mbikëqyrjes realizon marrëveshje bashkëpunimi reciproke në formën e Memorandumeve të Mirëkuptimit.

b) Instrumentet e procesit të mbikëqyrjes

Procesi i mbikëqyrjes realizohet nëpërmjet disa instrumenteve, ku përmendim:

- raportimin periodik të të dhënave mbi treguesit financiarë, nëpërmjet sistemit të raportimit të unifikuar. Nëpërmjet këtij sistemi raportues, bankat raportojnë në mënyrë periodike në Bankën e Shqipërisë vlerat e zërave të ndryshëm brenda dhe jashtë bilancit, si edhe tregues të ndryshëm të nevojshëm sipas kuadrit rregullator të mbikëqyrjes;
- raportimin e posaçëm të të dhënave të ndryshme, në kushtet kur gjykohet e nevojshme ndjekja nga afër e treguesve të caktuar;
- inspektimin në vend, gjatë të cilit kryet një verifikim i plotë (nëpërmjet përzgjedhjes), i të gjithë aktivitetit të bankës;
- analizat e njësisë së mbikëqyrjes nga jashtë (mbi bazën e të dhënave që i vijnë nëpërmjet sistemit raportues) dhe integrimi i këtyre analizave në planifikimin, në ndërtimin e strategjive dhe në kryerjen e inspektimeve në vend pranë bankave; ndërtimi i një linje të rregullt dhe të vazhdueshme komunikimi midis njësisë së mbikëqyrjes nga jashtë dhe njësisë së inspektimeve në vend;
- inspektimin në vend, gjatë të cilit kryhet një verifikim i plotë (nëpërmjet përzgjedhjes, në ato raste kur verifikimi i plotë nuk është i mundur), i një drejtimi të caktuar të aktivitetit të bankës, i një zëri të caktuar të bilancit të saj, i një procedure ose politike të caktuar dhe zbatimit të saj në praktikë, i sistemeve të kontrollit, i sistemeve të teknologjisë së informacionit etj.;
- kontaktet e vazhdueshme dhe/ose në vend, midis inspektorit që ndjek bankën dhe përfaqësuesve të saj, me qëllim ndjekjen e ecurisë së bankës, zbatimin e rekomandimeve të lëna në afat dhe me cilësi, dhe identifikimin e problemeve të ndryshme në kohë të hershme;
- kontakte dhe takime periodike midis përfaqësuesve të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe përfaqësuesve të bankave, për sqarimin e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë të dyja palët;
- takime midis drejtuesve të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe përfaqësuesve të këshillit drejtues dhe të asamblesë së aksionerëve të bankës, për adresimin e çështjeve të rëndësishme, të cilat kërkojnë zgjidhje në një nivel më të lartë hierarkik;
- takime të rregullta midis përfaqësuesve të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe përfaqësuesve të shoqërisë së auditimit të jashtëm, e cila auditon bankën, me qëllim përqëndrimin në problemet kryesore që shqetësojnë aktivitetin e bankës, njohjen me interpretimin e problemit sipas secilës palë dhe arsyet e këtij intepretimi, si edhe kryerjen e çdo përpjekjeje për arritjen e një qëndrimi të përbashkët mbi rrugëzgjdhjen;
- realizimin dhe përditësimin e dokumentit të strategjisë së bankës, në të cilin përfshihen të dhëna mbi problemet kryesore me të cilat ndeshet banka, rekomandimet e Bankës së Shqipërisë për zgjidhjen e tyre, progresi i realizuar në zbatimin e rekomandimeve, korrespondenca me bankën dhe strategjia që mendohet të ndiqet në vazhdim për adresimin e problemeve të bankës dhe për

procesin mbikëqyrës;

- krijimi dhe ruajtja me një informacion të përditësuar e bazës së të dhënave të Departamentit të Mbikëqyrjes, ku evidentohet dhe ruhen strategjitë e bankave, raportet e ekzaminimit, korrespondenca me bankat dhe çdo dokument tjetër i nevojshëm në procesin mbikëqyrës;
- përcaktimi dhe zbatimi i masave të ndryshme korrektuese, të cilat synojnë përmirësimin e gjendjes në bankë.

c) Profili i rrezikut

Vlerësimi i plotë i cilësisë së aktivitetit të bankës realizohet nëpërmjet inspektimeve në vend. Cilësia e një banke do të vlerësohet sipas sistemit CAMELS . Renditja që do të rezultojë sipas këtij vlerësimi, do të përcaktojë edhe profilin e rrezikut të bankës. Sipas renditjes, në shkallë rritëse, do të kemi këtë profil të rrezikut:

- CAMELS 1 “e fortë”, banka me rrezik të ulët;
- CAMELS 2 “e kënaqshme”, banka me rrezik të pranueshëm;
- CAMELS 3 “mesatarë”, banka me rrezik mesatar;
- CAMELS 4 “e dobët”, banka me rrezik të konsiderueshëm;
- CAMELS 5 “keq”, banka me rrezik të plotë ose të lartë.

Midis dy inspektimeve të plota në vend, për vlerësimin e profilit të rrezikut do të shërbejë renditja sipas CAELS, e realizuar nga Njësia e Analizës dhe e Mbikëqyrjes nga Jashtë. Nëse analistët e mbikëqyrjes nga jashtë dhe inspektori që ndjek bankën konfirmojnë ndryshimin (rënien) për dy periudha raportimi të njëpasnjëshme të renditjes sipas CAELS, krahasuar me renditjen më të fundit sipas CAMELS, atëherë për vlerësimin e profilit të rrezikut:

- organizohet një inspektim në bankë, i plotë ose i pjesshëm:
 - o i cili vlerëson në vend renditjen e plotë ose të cdo përbërësi të CAELS, i cili ka shkaktuar rënien e përgjithshme të renditjes. Në rastin e një inspektimi të plotë, përcaktohet renditja më e fundit sipas CAMELS;
 - o i cili vlerëson rrezikun dhe reagimin e administrimit (menaxhimit), si edhe përcakton ndikimin që ka ndryshimi i këtij profili të rrezikut në sigurinë dhe në gjendjen financiare të bankës.
- merret në konsideratë renditja sipas CAELS, në kushtet kur për arsye objektive inspektimi i plotë në bankë është i pamundur të kryhet në një periudhë prej 2-3 muajsh nga renditja e fundit sipas CAMELS, duke synuar kryerjen e një inspektimi të plotë në një periudhë sa më të shpejtë.

Për qëllime të procesit të mbikëqyrjes, bankat do të mbikëqyren sipas profilit të rrezikut, duke i përqëndruar burimet dhe kapacitetet mbikëqyrëse në bankat:

- me profil rreziku më të lartë;
- me profil rreziku që rritet përtej kualifikimit “të pranueshëm” (përtej “CAMELS 2”), midis dy inspektimeve të plota;

- të cilat kanë kaluar në procesin e administrimit dhe/ose të kujdestarisë në varësi të rolit që i njih Bankës së Shqipërisë, kuadri legjislativ dhe ai rregullativ.

ç) **Cikli i Mbikëqyrjes**

Me cikël të mbikëqyrjes do të kuptojmë periudhën maksimale midis dy inspektimeve të plota pranë një banke, si edhe numrin minimal të ngjarjeve që duhet të ndodhin gjatë tij.

Cikli i mbikëqyrjes mund të jetë normal, i përforcuar ose intensiv.

Cikli normal i mbikëqyrjes do të ketë një periudhë maksimale prej 18 muajsh midis dy inspektimeve të plota në vend. Numri minimal i ngjarjeve që duhet të ndodhin në këtë rast (duke përfshirë kontaktet e rregullta të inspektorit që ndjek bankën, me bankën), do të jenë:

- raportim periodik mujor sipas kërkesave të sistemit të raportimit të unifikuar;
- vlerësim çdo tre muaj i gjendjes së bankës dhe i profilit të rrezikut sipas CAELS dhe kryerje periodike e analizave që lidhen me sistemin e paralajmërimit të hershëm;
- një inspektim i plotë i veprimtarisë së bankës;
- një inspektim i plotë i një drejtimi të caktuar të veprimtarisë së saj, mbështetur në renditjen e bankës, në cilësinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportin e fundit të inspektimit dhe në problemet që janë identifikuar si rezultat i monitorimit të vazhdueshëm në vend ose nga jashtë;
- dy takime me administrimin e lartë të bankës, të cilat në kushte normale mund të shërbejnë për:
 - o një diskutim për rezultatin e tyre financiar, për burimet kryesore të të ardhurave dhe për pritshmërinë për të ardhmen,
 - o një pasqyrim të veprimeve korigjuese të ndërmarra për ndonjë dobësi të aktivitetit të bankës të identifikuar nga administrimi ose nga inspektorët e Bankës së Shqipërisë,
 - o një diskutim mbi zhvillimet më të rëndësishme që mund të kenë ndodhur në treg,
 - o një mundësi për të dhënë mesazhe të caktuara të Bankës së Shqipërisë, për bankën ose për sistemin bankar në përgjithësi,
 - o një mundësi për të përfituar komentet e bankës mbi mbikëqyrjen dhe rregullimin e saj nga ana e Bankës së Shqipërisë;
- një takim me përfaqësues të këshillit drejtues të bankës dhe/ose përfaqësues të asamblesë së aksionerëve të saj;
- një takim me auditorin e jashtëm të bankës;
- një takim ose një shkëmbim i zgjeruar i informacionit, me autoritetin mbikëqyrës të vendit ku banka ka selinë qendrore, në rastin e degës së një banke të huaj.

Si rregull, bankat të cilat kanë një profil rreziku të cilësuar “të ulët” (“CAMELS 1”) ose “të pranueshëm” (“CAMELS 2”), do të kenë një cikël normal të mbikëqyrjes. Përrjashtim nga ky rregull do të ketë në rastet kur gjatë periudhës, kanë ndodhur ngjarje, të cilat kërkojnë një cikël të përforcuar ose intensiv mbikëqyrjeje.

Cikli i përforcuar i mbikëqyrjes do të ketë një periudhë maksimale prej 12 muajsh midis dy inspektimeve të plota në vend. Ngjarjet minimale që duhet të ndodhin në këtë rast (duke përfshirë kontaktet e rregullta të inspektorit që ndjek bankën, me bankën), do të jenë:

- raportim periodik mujor sipas kërkesave të sistemit të raportimit të unifikuar;
- vlerësim çdo tre muaj i gjendjes së bankës dhe i profilit të rrezikut sipas CAELS dhe kryerje periodike e analizave që lidhen me sistemin e paralajmërimit të hershëm;
- një inspektim i plotë i veprimtarisë së bankës;
- dy inspektime të plota të një drejtimi të caktuar të veprimtarisë së saj mbështetur në renditjen e bankës, në cilësinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportin e fundit të inspektimit dhe në problemet që janë identifikuar si rezultat i monitorimit të vazhdueshëm në vend ose nga jashtë;
- takime periodike çdo tre muaj me administrimin e lartë të bankës, të cilat në këto kushte mund të shërbejnë për:
 - o të mbledhur informacion shtesë dhe për të diskutuar mbi progresin e bankës në drejtim të ruajtjes së niveleve të saj të kapitalit,
 - o të diskutuar mbi progresin e bankës në drejtim të sigurimit të burimeve të nevojshme të likuiditetit;
 - o t'u njohur dhe për të kërkuar masa konkrete nga ana e administrimit të bankës lidhur me përmirësimin e strukturës së të ardhurave dhe me reduktimin e shpenzimeve;
 - o të diskutuar mbi çdo çështje tjetër kritike për bankën, e cila nëse nuk adresohet në kohën dhe me efektivitetin e duhur, mund të sjellë përkeqësimin e mëtejshëm të situatës së bankës;
 - o të vendosur mbi masat korrektuese që duhet të ndjekë banka;
- informacion me shkrim të paktën një herë në muaj, lidhur me statusin e rekomandimeve të lëna nga Banka e Shqipërisë, gjatë inspektimit të plotë ose inspektimeve të pjesëshme;
- dy takime me përfaqësues të këshillit drejtues të bankës ose të asamblesë së aksionerëve të saj;
- takime periodike me auditorin e jashtëm të bankës (nëse është objektivisht e mundur);
- një takim ose një shkëmbim i zgjeruar i informacionit, me autoritetin mbikëqyrës të vendit ku banka ka selinë qendrore, në rastin e degës së një banke të huaj;
- një informacion me shkrim nga ana e Departamentit të Mbikëqyrjes, për

administratorët e Bankës së Shqipërisë, çdo tre muaj;

- një informacion me shkrim nga ana e Departamentit të Mbikëqyrjes për Këshillin Mbikëqyrës, çdo gjashtë muaj.

Bankat të cilat kanë një profil rreziku të cilësuar “mesatar”, do të kenë një cikël të përforcuar të mbikëqyrjes. Përfshirë nga ky rregull do të ketë në rastet kur gjatë periudhës, kanë ndodhur ngjarje të cilat të kërkojnë një cikël intensiv mbikëqyrjeje.

Cikli intensiv i mbikëqyrjes do të ketë një periudhë maksimale prej 6 muajsh midis dy inspektimeve të plota në vend. Ngjarjet minimale që duhet të ndodhin në këtë rast (duke përfshirë kontaktet e rregullta të inspektorit që ndjek bankën, me bankën), do të jenë:

- raportim periodik mujor sipas kërkesave të sistemit të raportimit të unifikuar;

- vlerësim çdo tre muaj i gjendjes së bankës dhe i profilit të rrezikut sipas CAELS dhe kryerje periodike e analizave që lidhen me sistemin e paralajmërimit të hershëm;

- një inspektim i plotë i veprimtarisë së bankës;

- një inspektim i plotë i një drejtimi të caktuar të veprimtarisë së saj mbështetur në renditjen e bankës, në cilësinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportin e fundit të inspektimit dhe në problemet që janë identifikuar si rezultat i monitorimit të vazhdueshëm në vend ose nga jashtë;

- takime periodike çdo muaj me administrimin e lartë të bankës, të cilat në këto kushte mund të shërbejnë për:

o të marrë informacion shtesë mbi vështirësitë që ndesh banka në drejtim të ruajtjes së niveleve të saj të kapitalit dhe për të ndrequr situatën;

o të diskutuar nevojat që ka banka në drejtim të likuiditetit të nevojshëm,

o t'u njohur dhe për të kërkuar masa konkrete nga ana e administrimit të bankës lidhur me përmirësimin e strukturës së të ardhurave dhe reduktimin e shpenzimeve,

o të diskutuar mbi cilësinë e asetëve të bankës,

o të diskutuar mbi aftësitë e administrimit për drejtimin e aktivitetit dhe masat që mendohet të merren lidhur me forcimin dhe me përmirësimin e strukturës së drejtimin, të funksionit të kontrollit të brendshëm etj.

- informacion me shkrim të paktën një herë në muaj, lidhur me statusin e rekomandimeve të lëna nga Banka e Shqipërisë, gjatë inspektimeve të plota ose të pjesshme;

- dy takime me përfaqësues të këshillit drejtues të bankës ose të asamblesë së aksionerëve të saj;

- takime periodike me auditorin e jashtëm të bankës (nëse është objektivisht e mundur);

- një takim ose një shkëmbim i zgjeruar i informacionit, me autoritetin mbikëqyrës të vendit ku banka ka selinë qendrore, në rastin e degës së një

banke të huaj;

- një informacion me shkrim nga ana e Departamentit të Mbikëqyrjes, për administratorët e Bankës së Shqipërisë dhe për Këshillin Mbikëqyrës, çdo tre muaj.

Bankat, të cilat kanë një profil rreziku të cilësuar “të konsiderueshëm” (“CAMELS 4”) dhe “të plotë-të lartë” (“CAMELS 5”), do të kenë një cikël intensiv të mbikëqyrjes.

Në rastet e ciklit të përforcuar dhe intensiv të mbikëqyrjes, nëse e gjykon të nevojshme, Banka e Shqipërisë përcakton detaje shtesë në mënyrën dhe kohën e raportimit të bankës dhe të vlerësimit të progresit të saj në zbatimin e masave korrektuese dhe në gjendjen dhe në progresin e realizuar në drejtime të caktuara të aktivitetit të saj.

Në kuadër të ngjarjeve të mësipërme, çdo informacion që merret, përpunohet dhe analizohet nga analisti përkatës që ndjek bankën (specialist i Njesisë së Analizës dhe të Mbikëqyrjes nga Jashtë), i përcillet inspektorit që ndjek bankën, i cili është përgjegjës për vlerësimin e përgjithshëm të progresit të bankës në kuadër të zbatimit të planit të masave korrektuese dhe të rekomandimeve të Bankës së Shqipërisë.

Veprimet penalizuese

Veprimet penalizuese janë instrumente të cilat përdoren në mbështetje të ciklit mbikëqyrës. Ato janë të përcaktuara në kuadrin legjislativ mbikëqyrës. Këtu mund të përmenden:

- vërejtjet me paralajmërim,
- gjobat,
- pezullimet,
- kërkesa për largim nga puna,

për çdo anëtar të administrimit të bankës, të këshillit drejtues dhe të komitetit të kontrollit, të cilët me paaftësinë, me veprimet dhe me mosveprimet e tyre, kanë cënuar kryerjen e një aktiviteti bankar të shëndoshë dhe të sigurtë.

Për bankat që i nënshtrohen një cikli të përforcuar dhe intensiv të mbikëqyrjes, përdorimi i veprimeve penalizuese të përmendura më sipër, në mënyrë të veçantë ose të kombinuar, kryhet duke gjykuar mbi përfundimet që janë nxjerrë gjatë ciklit të mbikëqyrjes mbi shkakun e krijimit të problemeve, mbi rëndësinë e tyre dhe ecurinë në kohë, përsëritjen ose jo, arsyet e mosadresimit të tij nga banka dhe administrimi, angazhimin e çdo hallke të administrimit në zgjidhjen e tij etj., si edhe ndikimin që këto kanë patur në sigurinë, në gjendjen financiare dhe në aftësinë paguese të bankës.

Në përfundim të çdo inspektimi të plotë si edhe në rastet kur kanë ndodhur ngjarje të caktuara që kërkojnë ndryshimin e renditjes së bankës, Departamenti i Mbikëqyrjes i njofton me shkrim bankat e nivelit të dytë për ciklin e mbikëqyrjes të cilit ato do t'i nënshtrohen në vijim.

Bankat të cilat marrin licencën nga Banka e Shqipërisë për të operuar, në vitin e parë të operimit të tyre, si rregull i nënshtrohen një cikli të përforcuar mbikëqyrjeje, pavarësisht nga profili i rrezikut.

Administrimi/Kujdestaria dhe likuidimi

Bankat të cilat kanë një nivel rreziku “të konsiderueshëm” ose “të plotë-të lartë”, mund të klasifikohen si banka të rrezikshme. Vendimet për masat korrektuese që mund të merren nga Banka e Shqipërisë në këtë rast, duhet të paraprihen nga një punë parapërgatitore për përcaktimin e saktë të efekteve të tyre mbi veprimtarinë e bankës, si edhe mbi Bankën e Shqipërisë.

Për bankat me profil rreziku si më lart, në varësi të:

- mbështetjes në aktet ligjore dhe të opinionit juridik;
- nivelit të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit;
- pritshmërisë për zhvillimet e ardhme;

Departamenti i Mbikëqyrjes mund t'i propozojë Guvernatorit dhe/ose Këshillit Mbikëqyrës marrjen e bankes nën administrim/kujdestari. Nëse ky proces nuk arrin ta rikthejë bankën në kushte normale të kryerjes së aktivitetit të saj, mund të kërkohet revokimi i licencës së bankës dhe kalimi i saj në procesin e likuidimit.

Ndërkohë që mënyra e kryerjes së procesit të likuidimit është përgjegjësi e likuidatorit, Departamenti i Mbikëqyrjes, për përcaktimin e procedurave që ndiqen për kryerjen e këtyre proceseve mbikëqyrëse, merr në konsideratë:

- natyrën ligjore të institucionit (bankë ose degë banke e huaj);
- madhësinë e bankës;
- peshën e saj në sistemin bankar;
- specialitetin e saj në një aktivitet të caktuar me rëndësi publike;
- integrimin e saj me pjesën tjetër të sistemit ose në tregun ndërkombëtar;
- cilësinë e aksionerëve dhe ecurinë me kapitalin;
- strukturën e aktiveve dhe të burimeve të bankës;
- zhvillimet e pritshme në të ardhmen.

Nga këndvështrimi i procedurave që ndiqen për bankat të cilat i drejtohen procesit të kujdestarisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, me qëllimin e krijimit të bindjes për mundësinë e mbijetesës së bankës pas procesit të kujdestarisë, i kushton vëmendjen e duhur elementeve të mëposhtme:

- njohjes në hollësi të historisë së problemeve që ka paraqitur banka dhe

identifikimin e problemeve kryesore;

- analizën e problemeve kryesore dhe krijimin e bindjes për zgjidhjen e tyre në një kohë të caktuar;
- analizën e strukturës së aktivitetit të bankës, të shtrirjes së saj, të përparësive që ofron;
- strukturës së depozitave të bankës si edhe të cilësisë së aktiveve të saj;
- mundësitë e ndryshimit të pronësisë së bankës nëpërmjet blerjes së saj nga aksionerë më të fuqishëm ose shkrirjes dhe bashkimit me një bankë ose institucion tjetër financiar.

Marrja e bankës në kujdestari synon rikthimin në gjendje të shëndetshme. Por nëse vërehet që banka vazhdon të paraqesë vështirësi të theksuara në aftësinë e saj pagueuse dhe në kapitalizimin e saj, aksionerët janë të pafuqishëm për të injektuar kapital shtesë, mundësitë e shitjes ose të shkrirjes së bankës me një institucion tjetër nuk ekzistojnë etj., pra situata në bankë është e pashpresë, Departamenti i Mbikëqyrjes, mbështetur në përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullativ, mund t'i propozojë Guvernatorit dhe/ose Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, revokimin e licencës së bankës dhe likuidimin e saj. Në varësi të perceptimit të vështirësisë së bankës, ky njoftim duhet të bëhet sa më shpejt nga marrja formale e bankës në kujdestari. Paralelisht me këtë propozim, paraqitet edhe plani i masave që do të merren në kuadër të procesit të likuidimit, të cilat minimalisht duhet të përmbajnë:

- opinionin juridik, mbështetjen në kuadrin legjislativ si edhe hartimin e çdo akti të nevojshëm ligjor, i cili standardizon procesin e likuidimit;
- një informacion mbi historinë e kontakteve me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, që prej marrjes së bankës në kujdestari dhe angazhimin e tyre në këtë proces;
- një informacion mbi kontaktet me aksionerët e bankës dhe qëndrimin e tyre ndaj likuidimit të mundshëm;
- një vlerësim mbi objektivat që duhet të plotësohen nëpërmjet likuidimit të bankës dhe renditja e detyrimeve të bankës sipas rëndësisë dhe shlyerjes së tyre;
- një vlerësim të fundit të aktivitetit të bankës, duke u përqëndruar në cilësinë e aktiveve të bankës dhe në strukturën e depozitave të saj. Për këtë moment, në varësi të kompleksitetit të aktivitetit të bankës, mund të angazhohet edhe një kompani auditimi e jashtme;
- propozimin për likuidatorin e bankës, duke respektuar kërkesat e akteve ligjore për këtë qëllim. Likuidatori i bankës mund të jetë një individ (punonjës ose jo i Bankës së Shqipërisë) ose një kompani auditimi. Mënyrat e përzgjedhjes dhe e pagimit, përcaktohen në varësi të natyrës së likuidatorit;
- një vlerësim mbi procesin e marrjes së kontrollit në bankë;
- një plan masash për kontaktet me departamente të tjera të Bankës së Shqipërisë dhe përcaktimin e veprimeve që mund të kryejë Banka e Shqipërisë nëpërmjet instrumenteve të saj, për sigurimin e likuiditetit të nevojshëm në sportelin e bankës, për minimizimin e rrezikut në sistem, për shpjegimin e

situatës në publik etj..

- një vlerësim mbi kontaktet me bankat e tjera, mbi ndarjen e informacionit në kohën e duhur dhe shpjegimin e situatës, mbi reagimet e tyre etj..
- një vlerësim mbi kontaktet me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të huaja, nëse nevojitet;
- një vlerësim mbi problemet që mund të shfaqen dhe mënyra e zgjidhjes së tyre;
- një plan masash mbi informimin e vazhdueshëm (të paktën çdo 15 ditë) të ecurisë së procesit të likuidimit, për Këshillin Mbikëqyrës dhe për administratorët e Bankës së Shqipërisë.

II. PROCEDURA TË ZBATIMIT TË FUNKSIONIT MBIKËQYRËS

Në Departamentin e Mbikëqyrjes, të gjitha hallkat e tij konceptohen si pjesë të një mekanizmi i cili, vetëm nëpërmjet shkëmbimit në kohën e duhur dhe në mënyrë të plotë të informacionit dhe të përfshirjes në vendimmarrje, nëpërmjet koordinimit të veprimeve të nevojshme dhe të transparencës së tyre, bën të mundur kryerjen me sukses të procesit mbikëqyrës.

Procesi i mbikëqyrjes realizohet nëpërmjet përcaktimit të kuadrit rregullativ dhe licencues dhe nëpërmjet verifikimit nga jashtë dhe në vend të zbatimit të tij.

a) Kuadri rregullativ dhe licencues

Detyrat e Departamentit të Mbikëqyrjes në fazën e licencimit të bankave, janë përcaktuar në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” dhe në rregulloret përkatëse që përcaktojnë kërkesat për licencimin e subjekteve që kërkojnë të kryejnë aktivitet si bankë. Ato kryhen nga Njësia e Licencimit dhe Rregullimeve, në Departamentin e Mbikëqyrjes.

Parimet

Kuadri rregullativ dhe licencues duhet të jetë:

- i plotë, dhe të pasurohet në vazhdimësi, sipas zhvillimeve të ndryshme në aktivitetin bankar brenda vendit dhe nevojave të tregut, si edhe të vështirësive ose nevojës për përmirësim që kanë dalë nga zbatimi i tij në praktikë;
- në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, për drejtimet e aktivitetit bankar që licencon dhe/ose që rregullon;
- i ndërtuar mbi bazën e një procesi të mjaftueshëm konsultimi paraprak dhe në vijimësi, ku janë shkëmbyer mendime në formë diskutimi ose me shkrim, brenda institucionit (veçanërisht me juristët) dhe me përfaqësues të rëndësishëm të palëve të interesuara si për shembull me bankat, me shoqëritë e auditimit të jashtëm, me shoqëri sigurimi, me institucione të tjera të sferës

financiare dhe ligjore etj.;

- i qartë dhe i kuptueshëm për subjektet që do ta zbatojnë dhe për grupet e tjera të interesuara që do ta konsultojnë, me qëllim shmangien e keqinterpretimeve.

Rishikimi

Kuadri rregullativ dhe licencues rishikohet në çdo rast kur zbatimi i tij i plotë në praktikë është i pamundur për arsye objektive, si edhe kur kanë ndodhur ndryshime paralele në akte të tjera ligjore dhe rregullative të lidhura me të. Vështirësia e funksionimit të kuadrit rregullativ dhe licencues në praktikë provohet nga diskutimet me subjektet që i nënshtrohen si edhe nga grupet e interesuara që e konsultojnë.

Publikimi

Çdo ndryshim i miratuar në kuadrin licencues dhe rregullativ, bëhet i njohur për departamentet në Bankën e Shqipërisë dhe publikohet sipas procedurave dhe detyrimeve përkatëse, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, në fletoren zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në faqen zyrtare të Internetit të Bankës së Shqipërisë etj.. Cdo ndryshim si më sipër, për efekt të publikimit në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, përkthehet edhe në gjuhën angleze.

b) Mbikëqyrja nga jashtë

Mbikëqyrja nga jashtë, synon identifikimin e problemeve në treguesit financiarë të bankave, mbështetur në sistemin raportues që ato dërgojnë në Bankën e Shqipërisë. Përveç këtij burimi, mbikëqyrja nga jashtë mund të shfrytëzojë edhe burime të tjera informacioni në Bankën e Shqipërisë, të cilat mundësojnë identifikimin në kohë sa më të shpejtë të zhvillimeve të padëshiruara në treguesit e bankës. Mbikëqyrja nga jashtë, do të kryhet nga Njësia e Analizës dhe Mbikëqyrjes nga Jashtë në Departamentin e Mbikëqyrjes.

Për qëllime të mbikëqyrjes nga jashtë, bankat do të monitorohen mbi baza të vazhdueshme nëpërmjet një sistemi raportimi periodik dhe të posaçëm nga ana e bankave, si edhe të analizave që mbështeten në manualët e mbikëqyrjes nga jashtë.

Sipas parashikimeve në kuadrin ligjor dhe rregullativ dhe mbështetur në iniciativën e njësive që kryejnë ekzaminimin e aktivitetit të bankës, Departamenti i Mbikëqyrjes, në situata të jashtëzakonshme, gjykon mbi nevojën që banka të caktuara, me zhvillime negative në profilin e rrezikut, të raportojnë të dhëna shtesë ose me frekuencë më të madhe, krahas mënyrës së raportimit në kushte normale.

Si rregull, propozimi për kërkesa shtesë në raportim mbështetet në komunikimin e rregullt midis analistit të njësisë së mbikëqyrjes nga jashtë që ndjek bankën dhe inspektorit që ndjek bankën. Këto kërkesa shtesë në raportim, do të synojnë të sigurojnë informacionin e nevojshëm për zhvillimet në tregues të ndryshëm të bankës që janë subjekt i masave korrektuese si edhe do të shërbejnë si kriter vlerësues i progresit të bankës dhe të administrimit të saj në zgjidhjen problemeve dhe në zbatimin e rekomandimeve. Propozimi për kërkesat shtesë në raportim, vlerësohet nga drejtuesit e departamentit dhe mund t'i dorëzohet për vendimmarrje Guvernatorit ose Këshillit Mbikëqyrës.

Funksioni

Mbikëqyrja nga jashtë është instrumenti kryesor, nëpërmjet të cilit mbikëqyren bankat në periudhën midis dy inspektimeve. Nëpërmjet saj:

- identifikohen në kohë ndryshimet në treguesit e një banke, si edhe prirja e tyre;
- verifikohen në kohë ndryshimet në treguesit që kanë qenë subjekt i veprimeve korigjuese dhe gjykohet mbi aftësinë e bankës për të adresuar problemet;
- ndërtohen analiza mbi ecurinë e bankave të veçanta dhe të sistemit bankar në tërësi, duke gjykuar mbi progresin dhe profilin e rrezikut të të gjithë sistemit;
- ofrohet një burim informacioni i cili mund të përdoret në Departamentin e Mbikëqyrjes (nga inspektorët dhe të tjerë) si edhe nga administratorët e bankës dhe grupe të tjera të interesuara, me qëllimin e njohjes së gjendjes reale të bankave të veçanta dhe të sistemit bankar në përgjithësi dhe, sipas nevojës, të reagimit në një kohë sa më të shpejtë.

Verifikimi i cilësisë së të dhënave

Njësia e Mbikëqyrjes nga Jashtë, kujdeset që të dhënat që vijnë nëpërmjet sistemit raportues:

- të përpunohen periodikisht në përputhje me mënyrën e përcaktuar në Manualin e Mbikëqyrjes nga Jashtë dhe në akte të tjera të miratuara;
- të kenë kuptim dhe të përfaqësojnë në mënyrë të qenësishme dhe të saktë aktivitetin e bankës;
- të jenë të plota, dhe në përputhje me standardet më të mira në këtë drejtim, duke gjeneruar propozimet për ndryshime nëse praktika dhe standardet më të mira e kërkojnë një gjë të tillë;
- të shërbejnë për identifikimin e ecurisë së treguesve të aktivitetit të bankës dhe të elementeve që janë subjekt i drejtpërdrejtë i kuadrit rregullativ, në mënyrë periodike;
- të ofrojnë informacionin e nevojshëm, sipas rastit të agreguar ose të detajuar, mbi bazën e të cilit mund të ndërtohen analizat ose studimet të cilat të përfshijnë çdo element të aktivitetit të bankës.

Shpërndarja e konkluzioneve

Njësia e Analizës dhe Mbikëqyrjes nga Jashtë, i shpërndan raportet konkluduese të sistemit raportues për të gjithë Departamentin e Mbikëqyrjes, duke tërhequr vëmendjen e bankave për tregues të cilët:

- o shfaqin një sjellje të panatyrshme,
- o kanë formuar një prirje negative, e cila mund të çojë në thyerjen e kufijve të përcaktuar për këtë tregues në kuadrin rregullativ;
- o përfaqësojnë tregues të cilët kanë qenë subjekt i rekomandimeve për përmirësim nga Banka e Shqipërisë, për të cilët kërkohet ndjekje e vazhdueshme;
- o kanë thyer kufijtë e përcaktuar në kuadrin rregullativ për ta;
- o tërheqin vëmendjen e analistit për arsye të tjera.

Integrimi

Me qëllimin e ndjekjes më nga afër të treguesve të bankave, puna e analistëve mund të organizohet në mënyrë të tillë që çdo analist të jetë përgjegjës për ndjekjen e një numri bankash të caktuara.

Analistët e Njesisë së Mbikëqyrjes nga Jashtë duhet të kontaktojnë me njësitë përgjegjëse për plotësimin e sistemit raportues në bankat e nivelit të dytë, në rastin kur vërehen pasaktësi në plotësimin e këtyre raporteve, me qëllim shmangien e tyre.

Analistët e Njesisë së Mbikëqyrjes nga jashtë duhet të marrin pjesë në ekzaminimet në vend që kryen Departamenti i Mbikëqyrjes, në rastet kur evidentojnë pasaktësi të përsëritura në sistemin raportues të bankave, me qëllim mirëinterpretimin e tyre në vend nga ana e specilistëve të bankës.

Analistët e Njesisë së Mbikëqyrjes nga jashtë vendosin kontakte të rregullta dhe të afërta me njësi të tjera të Bankës së Shqipërisë, që mund të jenë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave të sistemit raportues nga ana e bankave dhe përpunimin fillestar të tyre. Qëllimi është evidentimi i problemeve që paraqiten dhe zgjidhja e tyre në mënyrë të qëndrueshme.

E gjithë puna e kryer nga analistët e mbikëqyrjes nga jashtë me bankat respektive që mbulojnë, duhet të dokumentohet dhe në kohë reale t'i dërgohet për dijeni inspektorit që ndjek bankën.

Të gjitha produktet që realizon njësia e analizës nga jashtë, pasi të vihen në vëmendje të të gjithë Departamentit të Mbikëqyrjes (duke theksuar problemet më të mprehta dhe që kërkojnë vëmendje urgjente), duhet të hidhen në Bazën Elektronike të të Dhënave të Departamentit të Mbikëqyrjes menjëherë dhe në mënyrë të vazhdueshme.

Produktet

Produktet e Njesisë së analizës dhe të Mbikëqyrjes nga Jashtë, duhet të përmbajnë minimalisht:

- Një raport mujor mbi tendecat kryesore dhe problematikën e bankave dhe sistemit bankar;

Ky raport është një instrument i rëndësishëm që përdoret për të monitoruar dhe analizuar një bankë nëpërmjet mbikëqyrjes nga jashtë. Raporti është një analizë e gjerë e treguesve e të bilancit, pasqyrës së të ardhurave dhe të shpenzimeve dhe të dhënave të tjera periodike. Gjithashtu, ai pasqyron edhe shkeljet në zbatimin e kërkesave të kuadrit rregullativ të mbikëqyrjes.

- Një analizë të gjëndjes financiare të sistemit bankar, çdo tre muaj.

Kjo analizë shërben për të dhënë një vlerësim të situatës së përgjithshme të sistemit bankar, për të identifikuar zhvillimet pozitive dhe negative në sistem si edhe për të dhënë një parashikim afatshkurtër të zhvillimeve në të ardhmen. Këto analiza mbështeten në përdorimin e treguesve kryesorë dhe analizës së tendencës për sistemin bankar në tërësi dhe për grupe të veçanta bankash. Për këtë analizë përdoren elementet e klasifikimit CAMELS, të vlerësuara për të gjithë sistemin bankar dhe për një grup të caktuar bankash.

- Një analizë të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm për çdo bankë, çdo tre muaj.

Kjo analizë përfaqëson një sistem klasifikimi të unifikuar treguesish sasiorë dhe cilësorë si edhe një grup raportesh dhe koeficientësh që shërbejnë për të identifikuar mundësitë për tejkalimin e normave të mbikëqyrjes, ose masën e ekspozimit ndaj ndonjë rreziku specifik. Për çdo tregues përcaktohen kufijtë brenda të cilëve është normal ndryshimi i tyre. Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm identifikon problematikën e çdo banke. Shmangiet nga kufijtë normal të treguesve të monitoruar, mund të kërkojnë kryerjen e inspektimeve të shënjestruara ose mund të nxisin ndryshime në veprimet e mëparshme korrigjuese ose në strategjinë e mbikëqyrjes.

- Një analizë për secilën bankë sipas CAELS, çdo tre muaj.

Kjo analizë është një sistem vlerësimi sipas disa treguesve të unifikuar me treguesit që përdoren në raportet e inspektimit në vend. Shërben për të evidentuar nëse një bankë ka ndryshim apo jo në profilin e rrezikut të saj të përcaktuar në inspektimin e plotë në vend ose në analizën e një tremujori më parë.

c) Mbikëqyrja në vend

Mbikëqyrja në vend realizohet nëpërmjet verifikimit në vend të situatës së aktivitetit të bankës. Mbikëqyrja në vend realizohet nga Njësia e Inspektimeve

në Vend pranë Departamentit të Mbikëqyrjes. Në varësi të mbështetjes nga kadri rregullativ dhe të objektit të inspektimit, grupit të inspektorëve mund t'i bashkohen edhe specialistë të tjerë të departamenteve të Bankës së Shqipërisë, të cilët kërkojnë të monitorojnë nga afër një tregues ose një proces të caktuar të bankës. Inspektorët që bëjnë pjesë në njësi, përgjigjen për ndjekjen në vazhdimësi të bankave të veçanta, sipas përcaktimit të bërë nga drejtuesit e departamentit.

Llojet e inspektimeve

Inspektimet në vend mund të jenë:

- të plota;
- të pjesëshme (ose të shënjestruara).

Një inspektim i plotë është ai i cili mund të shtrihet në të gjithë aktivitetin e bankës dhe të njësive të lidhura me të. Në këtë inspektim shfrytëzohen të gjitha procedurat e inspektimit që janë të nevojshme për të arritur në vlerësimin e përbërësve të sistemit të vlerësimit dhe në përcaktimin e profilit të rrezikut për bankën.

Një ekzaminim i pjesshëm është çdo lloj inspektimi i cili shtrihet në një drejtim të caktuar të aktivitetit të bankës (ose të më shumë se një banke), që përfaqëson një rrezik specifik të identifikuar nga Njësia e Analizës dhe Mbikëqyrjes nga Jashtë, nga kontaktet me administrimin e bankës, nga raportimet mbi zbatimin e rekomandimeve që lidhen me inspektimin e fundit në vend, nga kontrolli i pasqyrave financiare të bankës, nga informacionet e ndryshme etj.. Ky inspektim është i kufizuar në kohë dhe në procedura.

Në çdo inspektim në vend për qëllime të mbikëqyrjes, marrin pjesë të paktën dy inspektorë. Në çdo inspektim, nga drejtuesit e departamentit caktohet "inspektori përgjegjës", i cili përfaqëson antarin e grupit të inspektimit, që e udhëheq atë gjatë procesit të inspektimit. Inspektori që ndjek bankën që do të inspektohet, si rregull, duhet të jetë anëtar i grupit të inspektimit. Procedurat e kryerjes së inspektimit, janë parashikuar në hollësi në Manualin e Inspektimeve në Vend. Procedurat e përmendura më poshtë, do të synojnë të japin një kuadër të përgjithshëm dhe të plotësorë procedurat ekzistuese.

Fazat e procesit të inspektimit

Ne kushte normale, inspektimet planifikohen nga drejtuesit e Departamentit të Mbikëqyrjes, mbështetur në strategjinë e mbikëqyrjes të secilës bankë. Ky plan, miratohet nga administratori përkatës që mbulon departamentin ose, nëse kërkohet, kalohet për miratim në Këshillin Mbikëqyrës. Programi mund të rishikohet nëse ndodhin zhvillime objektive në kuadrin mbikëqyrës.

Procesi i inspektimit në vend, pavarësisht nga forma e tij, kalon në tre faza:

- ndjekja e bankës dhe përgatitja për inspektim (procesi i parainspektimit),
- kryerja e inspektimit dhe dhënia e konkluzioneve,
- përgatitja e raportit, përcaktimi i rekomandimeve dhe ndjekja e zbatimit të tyre.

Përgatitja për inspektim e grupit të inspektimit, mbështetet kryesisht në punën e kryer nga inspektori që ndjek bankën dhe në shkëmbimin e informacionit me njësi të tjera të departamentit. Përgatitja për inspektim konsiston:

- në konsultimin me Strategjinë e mbikëqyrjes së bankës, si edhe me Bazën e të Dhënave të Departamentit të Mbikëqyrjes, e cila duhet të përmbajë shumë nga elementet e tjera në vijim;
- në rishikimin e inspektimeve të mëparshme dhe duke përcaktuar statusin e rekomandimeve të lëna gjatë tyre;
- në rishikimin e analizave periodike të kryera nga analistët e mbikëqyrjes nga jashtë dhe në evidentimin e treguesve problematikë;
- në identifikimin e problemeve që ekzistojnë në kuadrin licencues dhe rregullativ, nëpërmjet kontakteve dhe informacioneve të përgatitura nga njësia e licencimit dhe rregullimeve;
- në rishikimin e të gjithë korrespondencës midis bankës dhe Bankës së Shqipërisë, për qëllime të mbikëqyrjes,;
- në ndjekjen me vëmendje të të gjitha burimeve të tjera të informacionit që japin informacion mbi ecurinë e bankës si për shembull, Autoriteti Mbikëqyrës i një vendi të huaj, banka-mëmë në rastin e degës së bankës, kompania e auditimit të jashtëm, media, zërat në treg etj.;
- në konsultimin me politikat, procedurat dhe dokumente të tjera të bankës, të cilat i janë kërkuar t'i sjellë paraprakisht në Departamentin e Mbikëqyrjes me qëllim analizimin e tyre në avancë për të rritur kështu efektivitetin e inspektimit si edhe për të shkurtuar në maksimumin e nevojshëm kohën e kryerjes së inspektimit;
- një përcaktim në lidhje me degët apo me njësitë e lidhura që do të ekzaminohen;
- një përgatitje e një axhende mbi diskutimet fillestare me drejtuesit e bankës.

Mbështetur në këtë përgatitje, inspektori përgjegjës drejton grupin e inspektimit në përgatitjen e një analize të ecurisë dhe të problematikës së bankës. Drejtuesit e departamentit realizojnë një takim paraprak me grupin e caktuar të inspektimit dhe analistë të Njesisë së Analizës dhe Mbikëqyrjes nga Jashtë (specialistë të tjerë mund të ftohen të marrin pjesë në takim), për të diskutuar mbi problemet e bankës që do të inspektohet dhe për të përcaktuar prioritetet që do të jenë në qendër të vëmendjes së grupit të inspektimit.

Mbi bazën e këtij takimi, inspektori përgjegjës ndërton programin e inspektimit, i cili do të kushtëzohet nga forma e inspektimit . Ky program inspektimi (i cili

minimalisht duhet të përmbajë: emrat e inspektorëve dhe përgjegjësitë e secilit gjatë inspektimit, kohën e planifikuar të inspektimit - jo më shumë se 22 ditë pune, objektin e inspektimit, drejtimet/elementet e aktivitetit të bankës që do të inspektohen, dokumentacionin që kërkohet për inspektim) i dorëzohet drejtuesve të departamentit dhe miratohet prej tyre. Inspektori përgjegjës, ndjek dërgimin e programit të inspektimit, pranë bankës që do të inspektohet, duke lejuar për një periudhë maksimale kohe deri në 7 ditë pune për fillimin e tij.

Kohëzgjatja e inspektimit, periudha për t'u inspektuar si dhe përbërja e grupit të inspektimit përcaktohen nga drejtuesit e Departamentit të Mbikëqyrjes në bashkëpunim me inspektorin përgjegjës. Për këtë shërbejnë elementë të tilla si: objekti i inspektimit, madhësia e bankës dhe problematika që paraqet, orët e nevojshme të punës etj.. Periudha për t'u inspektuar duhet të mbulojë periudhën e aktivitetit të bankës, që prej inspektimit të plotë të fundit. Grupi i inspektimit duhet t'i kushtojë vëmendje çdo të dhënë tjetër e cila nuk i korrespondon periudhës që inspektohet, por që shërben për të arritur në konkluzione të vlefshme për gjendjen financiare të bankës. Në raportin e inspektimit, grupi i inspektimit do të japë vlerësime edhe për rreziqet që mund të ndeshë banka në të ardhmen.

Në përcaktimin e grupit të inspektimit bëhet kujdes që të mos caktohen inspektorë, të cilët kanë një konflikt interesi me bankën që inspektohet, për të mos cënuar në asnjë formë procesin e inspektimit. Çdo inspektor që ka konflikt interesi me një bankë që do të inspektohet, duhet ta deklarojë këtë gjë me shkrim përpara inspektimit dhe t'ja paraqesë drejtuesve të departamentit.

Inspektori përgjegjës, gjatë bashkëpunimit me grupin e inspektimit, identifikon aftësitë e tyre në drejtime të caktuara të inspektimit. Në fund të procesit të inspektimit, ai i dorëzon drejtuesve të departamentit një vlerësim mbi punën e kryer nga çdo anëtar i grupit të inspektimit, duke përcaktuar përparësitë dhe dobësitë e tyre.

Kryerja e inspektimit, fillon me takimin njohës që realizon grupi i inspektimit me drejtuesit e bankës që do të inspektohet. Inspektori përgjegjës, krahas prezantimit të grupit dhe të mënyrës së planifikuar të inspektimit, kërkon edhe një herë nga drejtuesit e bankës angazhimin e tyre për krijimin e lehtësirave të nevojshme në akomodim, në komunikimin me stafin e bankës gjatë inspektimit dhe në sigurimin në kohë të dokumentacionit dhe informacionit shtesë të kërkuar.

Gjatë inspektimit, inspektori përgjegjës, përfaqëson grupin e inspektimit në komunikimin me drejtuesit e bankës. Anëtarët e grupit të inspektimit, nëse e gjykojnë të nevojshme për mbledhjen e informacionit dhe për të sqaruar më në detaje çështje të ndryshme, krahas personit të kontaktit të përcaktuar nga banka, vendosin raporte të drejtpërdrejta komunikimi edhe me personelin e

bankës i cili është përgjegjës për aktivitetet që inspektohen. Në çdo rast, inspektorët kujdesen që të respektojnë kërkesat e Kodit të Etikës për një komunikim normal, të evitojnë përcaktimet për cilësinë e punës së personelit, si edhe të ruajnë konfidencialitetin të dhënave. Grupi i inspektimit, respekton procedurat e punës dhe rregullat e vendosura nga banka në drejtim të qëndrimit dhe të lëvizjes në bankë. Në rastet e mungesës së një sjelljeje korrekte nga ana e personelit të bankës, këto evidentohen nga anëtarët e grupit të inspektimit pranë inspektorit përgjegjës dhe i bëhen të ditura drejtuesve të bankës në një kohë sa më të shpejtë gjatë inspektimit.

Gjatë gjithë inspektimit, ekziston një komunikim i rregullt midis anëtarëve të grupit të inspektimit dhe Departamentit të Mbikëqyrjes, me qëllim ndjekjen e të gjithë procesit gjatë kohës së kryerjes së tij dhe informimin dypalësh mbi zhvillime të rëndësishme.

Gjatë kryerjes së inspektimit, grupi i inspektimit shfrytëzon në mënyrë të plotë kohën e punës në bankë dhe si rregull, respekton kohën e planifikuar të inspektimit. Nëse e gjykon të nevojshme, inspektori përgjegjës kërkon pranë drejtuesve të Departamentit të Mbikëqyrjes zgjatjen e kohës së inspektimit, duke dhënë arsye të përkatëse.

Grupi i inspektimit mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm dhe realizon dokumentimin e tij nëpërmjet fletëve të punës. Fletët e punës nevojiten për të dokumentuar punën e kryer dhe për të mbështetur e vërtetuar komentet në raportin e inspektimit. Ato mund të përfshijnë procedurat dhe pyetësorët përkatës të çështjeve të inspektuara si për shembull, pyetësorin e sistemit të kontrollit për fushat e inspektuara, formularët e dokumentacionit të investimeve dhe të kredive (nëse janë të aplikueshme), formularë të tjerë, analiza të kryera nga inspektori, pasqyrat statistikore të inspektuara, kopje të regjistrimeve bankare, politika, procedura dhe çdo dokument tjetër që shërben për arritjen e konkluzioneve në analizat dhe vlerësimet e inspektorëve. Dosjet e fletëve të punës të çdo inspektimi do të ruhen për të mundësuar shfrytëzimin e tyre për materiale të tjera në departamentin e Mbikëqyrjes.

Në momentin e përfundimit të inspektimit në vend, inspektori përgjegjës dhe grupi i inspektimit realizojnë një takim përmbyllës jozyrtar, në të cilin njihen drejtuesit e bankës me gjetjet kryesore të grupit të inspektimit (por pa dhënë opinione mbi renditjen dhe masat që do të rekomandohen).

Puna për hartimin e raportit të inspektimit, intensifikohet me kthimin në Bankën e Shqipërisë, të grupit të inspektimit. Raporti duhet të realizohet deri në 5 ditë pune pas përfundimit të inspektimit. Çdo anëtar i grupit të inspektimit, është përgjegjës për hartimin e pjesës së tij të raportit të inspektimit, sipas drejtimin të aktivitetit të bankës që ka inspektuar. Inspektori përgjegjës dhe anëtarët e tjerë të grupit të inspektimit i diskutojnë gjetjet e inspektimit me

drejtuesit e departamentit, me analistët e mbikëqyrjes nga jashtë dhe nëse nevojitet edhe me punonjësit e sektorit të licencimeve dhe rregullimeve, duke synuar saktësimin e tyre. Nëse gjykohet i nevojshëm nga inspektori përgjegjës ose nga drejtuesit e departamentit, organizohet edhe një takim me auditorine jashtëm të bankës së inspektuar. Mbi bazën e gjetjeve nga inspektimi, si edhe të renditjes së propozuar, formulohen edhe rekomandimet përkatëse me afatet respektive të përmbushjes së tyre.

Në përfundim të procesit të inspektimit (duke përfshirë edhe hartimin e raportit të inspektimit), merret një takim zyrtar me drejtuesit e bankës së inspektuar. Nëse ka ndryshime të ndjeshme në gjetjet dhe konkluzionet e raportit të inspektimit krahasuar me ato të përmendura në takimin paraprak përmbyllës, në varësi të rëndësisë së problemit dhe madhësisë së bankës, nga Banka e Shqipërisë, përveç inspektorit përgjegjës mund të marrin pjesë edhe drejtues të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe, në raste të jashtëzakonshme, administratorë të Bankës së Shqipërisë.

Raporti i inspektimit, i cili përmban një përmbledhje të rekomandimeve kryesore (për këshillin drejtues ose administrimin e bankës) së bashku me afatet paraprake të realizimit të tyre, si edhe të gjithë analizën e detajuar të grupit të inspektimit për inspektimin e kryer, nënshkruhet nga inspektori përgjegjës dhe përgjegjësi i njësisë së inspektimeve në vend, dhe i dërgohet bankës i shoqëruar nga një letër përcjellëse e nënshkruar nga drejtori i departamentit. Mbështetur në vështirësitë në të cilat gjendet banka dhe në vlerësimin e profilit të rrezikut të saj pas inspektimit të fundit, raporti i inspektimit mund të përcillet pranë bankës me një letër të nënshkruar nga administratorët e Bankës së Shqipërisë.

Pas dërgimit të raportit dhe njohjes me përmbajtjen e tij, bankës i lihet kohë deri në 15 ditë pune për të reaguar ndaj rekomandimeve të përfshira në raportin e inspektimit dhe afateve të realizimit të tyre. Deri në 5 ditë pune pas marrjes së këtij reagimi, Departamenti i Mbikëqyrjes përgatit dhe dërgon rekomandimet përfundimtare dhe afatet finale të realizimit të tyre. Nëse ky reagim i bankës nuk vjen brenda kohës së përcaktuar dhe kjo vonesë nuk justifikohet paraprakisht nga ana e bankës, rekomandimet dhe afatet e dërguara në raport konsiderohen përfundimtare. Nëse banka kërkon shtyrje të afatit për të reaguar, e arsyetuar kjo në një mënyrë që Banka e Shqipërisë e konsideron të pranueshme, banka njoftohet për afatin e ri duke u siguruar që, koha e përgjithshme e kaluar që prej dërgimit të raportit, të mos kalojë 45 ditë kalendarike. Nëse arsyetimi i bankës për shtyrjen e afatit të reagimit konsiderohet i pamjaftueshëm dhe jobindës, banka njoftohet që në fuqi mbeten rekomandimet dhe afatet e përcaktuara fillimisht.

Inspektori përgjegjës, në përfundim të procesit të inspektimit, vlerëson anëtarët e grupit të inspektimit sipas formularëve përkatës.

Të gjitha materialet që lidhen me inspektimin e kryer, i dorëzohen inspektorit që ndjek bankën, i cili realizon hedhjen e tyre në Bazën Elektronike të të Dhënave dhe ngarkohet me ruajtjen e të gjithë dokumentacionit (ose arkivimin e tij).

Raporti i inspektimit është një dokument konfidencial, i cili do të ruhet brenda Departamentit të Mbikëqyrjes. Ai nuk mund të përdoret në asnjë rast për qëllime personale dhe të bëhet publik pa miratimin paraprak të bankës së inspektuar. Çdo lëvizje e raportit jashtë Departamentit të Mbikëqyrjes, duhet të shoqërohet me cilësimin e tij në një vend të dukshëm, si konfidencial. Inspektorët e departamentit të Mbikëqyrjes dhe çdo person tjetër që i bashkohet grupit të inspektimit, duhet të trajtojnë si “konfidencial” çdo informacion ose të dhënë me të cilën janë njohur gjatë inspektimit në bankë.

Raporti hartohet dhe i dërgohet bankës në gjuhën shqipe. Në rastin kur ai shërben për t'i dërguar informacion Autoritetit Mbikëqyrës të një vendi të huaj, realizohet një përmbledhje e gjetjeve kryesore të tij si edhe e rekomandimeve, në gjuhën angleze.

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve bëhet nga inspektori përkatës, i cili ka për detyrë që:

- të jetë në kontakt të vazhdueshëm me bankën për njohjen e statusit të rekomandime;
- të njoftojë në mënyrë të vazhdueshme me shkrim, pranë drejtuesve të departamentit, lidhur me ecurinë e bankës në zbatimin e rekomandimeve;
- të kërkojë pranë drejtuesve të departamentit planifikimin e një inspektimi të pjesshëm, me qëllim verifikimin në vend të realizimit të rekomandimeve;
- të veprojë si hallkë lidhëse midis Bankës së Shqipërisë dhe bankës që mbulon për organizimin dhe bashkërendimin e takimeve dypalëshe në nivele të ndryshme, ku do të diskutohen problemet e bankës dhe të mbikëqyrjes së saj;
- të dokumentojë çdo zhvillim në kontaktet me bankën;
- të evidentojë çdo element të marrëdhënieve me bankën për qëllime të procesit mbikëqyrës, në Bazën Elektronike të të Dhënave, në mënyrë të menjëhershme dhe të vazhdueshme;
- të modifikojë Strategjinë e mbikëqyrjes së bankës, sipas ecurisë më të fundit, duke projektuar në këtë mënyrë edhe inspektimin e ardhshëm dhe duke plotësuar ciklin e mbikëqyrjes.

d) Strategjitë

Qëllimi

Në procesin e mbikëqyrjes është i nevojshëm hartimi i një dokumenti i cili të jetë në gjendje që në mënyrë të përmbledhur dhe të qenësishme të tregojë vlerësimin e rrezikut të një banke si edhe elementët ku mbështetet ky vlerësim.

Mbi bazën e këtij vlerësimi, ndërtohet edhe plani i mbikëqyrjes së kësaj banke. Të gjitha këto elemente bëjnë pjesë në një dokument i cili quhet Strategjia e mbikëqyrjes.

Strategjia e mbikëqyrjes, është një dokument i veçantë për secilën bankë. Ajo ndërtohet nga inspektori që ndjek bankën, mbështetur në informacionin që sigurohet nëpërmjet inspektimeve në vend, kontakteve me bankën, bashkëpunimit me analistët e mbikëqyrjes nga jashtë dhe njësi të tjera të Departamentit të Mbikëqyrjes ose të Bankës së Shqipërisë etj.. Strategjia miratohet nga drejtuesit e Departamentit të Mbikëqyrjes. Ajo duhet të paraqesë një pamje të qartë të anëve të forta dhe për më tepër, të anëve të dobëta të një banke, duke identifikuar ato drejtime të cilat kanë nevojë për një mbikëqyrje të veçantë.

Nëse konsiderohet e nevojshme, Strategjia e mbikëqyrjes hartohet dhe mbahet edhe në gjuhën angleze.

Struktura

Ndonëse përmbajtja e çdo strategjie është e ndryshme (në varësi të profilit të rrezikut të secilës bankë), strukturimi i saj duhet të realizohet sipas një forme të caktuar, në mënyrë që lexuesi i saj të jetë në gjendje të kuptojë pa vështirësi:

- problemet kryesore që ndesh banka dhe rrezikun që ato përfaqësojnë për aktivitetin e saj;
- përpjekjet që bën banka, e mbështetur nga aktiviteti mbikëqyrës, për të zgjidhur problemet e identifikuar dhe rezultatit e këtyre përpjekjeve;
- cili është profili i rrezikut të bankës, a janë identifikuar mirë rreziqet kryesore, a është përfshirë ndjekja dhe adresimi i tyre në strategji sipas përparësive;
- cila është strategjia e ndërtuar e mbikëqyrjes, për të mbështetur përpjekjet e bankës për të zgjidhur problemet? A është zbatuar ajo? A ka patur sukses deri tani dhe si vlerësohet e ardhmja e saj etj..

Përmbajtja

Të gjitha strategjitë, duhet të përmbajnë:

- pjesën hyrëse, ku në mënyrë të përmbledhur jepet një vlerësim i gjendjes së përgjithshme të bankës, duke përmendur problemet kryesore. Qëllimi në këtë pjesë, është që të evidentohen më qartë drejtimet e aktivitetit të bankës të cilat përfaqësojnë edhe rrezikun më të lartë për mbarëvajtjen e saj. Në këtë pjesë jepet natyra ose lloji i çdo rreziku, si edhe gjykimi i Departamentit të Mbikëqyrjes për adresimin e tij. Gjithashtu në këtë pjesë, jepet edhe një vlerësim mbi integritetin dhe mënyrën e operimit të bankës në të gjithë sistemin bankar;
- pjesën qendrore, ku jepen më të detajuara karakteristikat e bankës dhe problematika e saj, mbështetur në inspektime të plota ose të pjesshme që janë

kryer si edhe në rekomandimet e lëna. Në këtë pjesë, pasqyrohen edhe masat që ka marrë banka për zbatimin e rekomandimeve dhe statusin e tyre. Çdo rrezik i përmendur në pjesën hyrëse, trajtohet në mënyrë të zgjeruar në këtë pjesë, duke dhënë shkakun e krijimit dhe burimin e tij, historinë e tij në aktivitetin e bankës, përpjekjet që ka bërë banka për zgjidhjen ose minimizimin e tij, suksesin e këtyre përpjekjeve dhe gjendjen aktuale;

- pjesa përmblylëse, ku pasqyrohet programi i mbikëqyrjes së kësaj banka gjatë ciklit të ardhshëm të mbikëqyrjes. Në këtë pjesë përfshihen numri i inspektimeve të plota ose të pjesshme të planifikuara dhe problemet që do të jenë në qendër të tyre, takimet me administrimin dhe/ose këshillin drejtues të bankës dhe tematika e planifikuar e tyre. Në këtë pjesë jepen në mënyrë më të detajuar renditja e secilës bankë sipas CAMELS, si edhe vlerësimet e fundit sipas CAELS (mbështetur nga arsyet e vlerësimit). Vlerësimet sipas CAMELS dhe CAELS, ndonëse realizohen në mënyrë të veçantë duhet të analizohen në mënyrë të përbashkët si pjesë e të njëjtit proces vlerësimi. Rezultatet e tyre duhet të mbështeten me arsyetimet e dhëna në tekstin e Strategjisë.

- Aneksi ose pjesa shtesë, në të cilën çdo inspektor që ndjek bankën, mbi bazën e gjykimit të tij dhe në mbështetje të realizimit të qëllimeve të strategjisë në një mënyrë të plotë dhe të përmbledhur, si edhe duke ruajtur kuadrin "strategjik" të dokumentit, do të trajtojë përmbledhurazi elementet e mëposhtëm:

o një histori të shkurtër të bankës që prej licencimit të saj, dhe problemet kryesore që ka shfaqur;

o një strukturë të aksionerëve të saj kryesorë dhe një vlerësim të gatishmërisë së tyre për të qëndruar pranë bankës, për të tërhequr ose për të akumuluar dividentin, për të injektuar kapital shtesë në rast nevojë, vështirësitë që kanë patur në aktivitete të tjera paralele dhe problemet që kjo mund të sjellë në aktivitetin e bankës, ndryshimet në rradhët e aksionerëve etj.;

o një strukturë të këshillit të saj drejtues, plotësinë e kësaj strukture, përvojën e anëtarëve dhe të kryetarit të tij, angazhimin e tyre në zgjidhjen e problemeve të bankës, reagimin e tyre ndaj raporteve të inspektimit të Bankës së Shqipërisë, takimet e kryera prej tyre me Bankën e Shqipërisë, vlerësimet që ata i kanë bërë administrimit të bankës etj.;

o një strukturë të Komitetit të Kontrollit, historinë e krijimit, përvojën e anëtarëve dhe të kryetarit, funksionet e tyre jashtë bankës, angazhimin e tyre në ndjekjen e problemeve të bankës, marrëdhëniet brenda tyre dhe përgjegjësitë e secilit, marrëdhëniet me njësinë e kontrollit të brendshëm dhe me këshillin drejtues, raportet që kanë dërguar pranë këshillit drejtues, takimet që kanë organizuar në bankë si edhe me Bankën e Shqipërisë, vlerësimet që i kanë bërë njësisë së funksionit të kontrollit të brendshëm, raportet e tyre me auditorët e jashtëm etj.;

o strukturën dhe eficiencën e administrimit të bankës, përvojën dhe aftësitë e tyre në drejtimin e aktivitetit, rezultatet, përgjegjësitë e tyre në aktivitetin e përditshëm të bankës, raportet e tyre me këshillin drejtues dhe aksionerët, raportet e tyre me personelin, aftësinë e tyre për ndarjen e plotë të përgjegjësiave

në bankë dhe ushtrimin e një kontrolli efektiv nëpërmjet sistemeve bashkëkohore të informacionit, reputacionin e tyre në treg, bashkëpunimin e tyre dhe korrektesën në marrëdhëniet me Bankën e Shqipërisë etj.;

o një vlerësim mbi biznesin e kryer nga banka që prej licencimit të saj, mbi ecurinë e aktivitetit, mbi plotësimin e pritshmërive që ka patur banka në drejtim të biznesit të saj (përputhje me biznesplanin), mbi arsyet e mosrealizimit, mbi peshën që zë banka në sistemin bankar, mbi avantazhet dhe disavantazhet që ofron krahasuar me bankat e të njëjtit grup etj.;

o një vlerësim mbi administrimin e aktiveve të bankës, duke përfshirë zërat kryesorë të investimeve, portofolin e kredive dhe cilësinë e tij, prirjet që vihen re, analizat që shoqërojnë vendimet investuese, njohjen reale të rreziqeve që përmbajnë këto investime nga ana e personelit dhe e drejtimit të bankës etj..

o një vlerësim mbi rezultatin financiar të bankës, nëse ai përfaqëson një "barrë" në ecurinë e bankës prej shumë kohësh ose kur paraqet ndryshime të shpejta, të cilat kërkojnë analiza më të thella dhe të detajuara;

o një vlerësim mbi zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi nga ana e bankës, përveç të tjerash, edhe lidhur me kërkesat në parandalimin e pastrimit të parave, marrëdhëniet me personat e lidhur etj.;

o çdo vlerësim për një element tjetër, i cili konsiderohet i rëndësishëm për mbarëvajtjen e aktivitetit të bankës.

Ndryshimi dhe përgjegjësitë

Strategjia e mbikëqyrjes së bankës, duhet të modifikohet pas çdo inspektimi të plotë, duke reflektuar gjetjet më të fundit dhe vlerësimin aktual të profilit të rrezikut të saj. Por dokumenti i strategjisë së mbikëqyrjes së bankës, mund të ndryshojë edhe në periudhën midis dy inspektimeve të plota, duke u mbështetur në të dhënat më të fundit të bankës (si rezultat i kontakteve të drejtpërdrejta me bankën ose në sajë të shkëmbimit të informacionit me Njësinë e Analizës dhe Mbikëqyrjes nga Jashtë).

Inspektori që ndjek bankën është përgjegjës për propozimin e ndryshimit të strategjisë mbikëqyrëse, duke sugjeruar ndryshimin e programit të ngjarjeve të mbikëqyrjes që janë planifikuar të ndodhin në pjesën përmbyllëse të strategjisë. Ky propozim, nëse konsiderohet i pranueshëm, miratohet nga drejtuesit e Departamentit të Mbikëqyrjes. Inspektori që ndjek bankën, është përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e programit të strategjisë së mbikëqyrjes së bankës, duke u siguruar që ngjarjet mbikëqyrëse të parashikuara, janë përfshirë në planet e punës së departamentit.

Strategjia e mbikëqyrjes së çdo banke, duhet të përfaqësojë një dokument të integruar, ku lexuesi duhet të kuptojë që konkluzionet e arritura brenda saj janë të mbështetura siç duhet në punën që ka bërë çdo hallkë e Departamentit të Mbikëqyrjes, duke përfshirë inspektorin që ndjek bankën, grupin e inspektimit që e ka inspektuar bankën, analistët e mbikëqyrjes nga jashtë, drejtuesit e

departamentit dhe administratorët e Bankës së Shqipërisë. Në këtë dokument duhet të identifikohen qartë linjat e komunikimit brenda departamentit si edhe midis departamentit dhe administratorëve të Bankës së Shqipërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës.

Strategjia e mbikëqyrjes së çdo banke, duhet njëherazi të tregojë qartë komunikimin që ka ekzistuar midis Bankës së Shqipërisë (Departamentit të Mbikëqyrjes) dhe bankës së nivelit të dytë, si edhe rezultatin e këtij komunikimi. Mbi këtë bazë mund të vlerësohet nëse ky komunikim ka qenë i plotë, në shërbim të aktivitetit mbikëqyrës dhe së fundi, i suksesshëm.

Strategjia e mbikëqyrjes, përfaqëson një nga dokumentet kryesore që i shërbejnë vlerësimit të procesit mbikëqyrës, ndërtuar në kuadër të Procesit të Sigurimit të Cilësisë.

e) Baza Elektronike e të Dhënave (BED)

BED përfaqëson një vend të përcaktuar në serverin e Bankës së Shqipërisë (në rrjetin e brendshëm të saj), ku evidentohet dhe ruhet i gjithë aktiviteti mbikëqyrës ndaj bankave të veçanta ose sistemit bankar në tërësi. BED duhet të përmbajë minimalisht:

- raportet e inspektimit të secilës bankë, pavarësisht nga forma e inspektimit;
- strategjitë e mbikëqyrjes të secilës bankë;
- dokumente të ndryshme të analizave të kryera nga njësitë e Departamentit të Mbikëqyrjes; të kategorizuara për sistemin bankar në tërësi ose për banka të veçanta;
- dokumente të ndryshme të korrespondencës me bankën (për qëllime të aktivitetit mbikëqyrës);
- dokumente të ndryshme të kontakteve dhe të bashkëpunimit me institucione të tjera të rëndësishme në plotësimin e kuadrit mbikëqyrës të bankave;
- dokumente të tjera që i takojnë Departamentit të Mbikëqyrjes, si politika, manuale, vlerësime etj..

Sipas natyrës së të dhënave që hidhen në BED, përcaktohen edhe njësitë përbërëse të Departamentit të Mbikëqyrjes që janë përgjegjëse për reflektimin e tyre në BED. Si rregull, njësia e departamentit e cila merr e para informacionin nga banka ose e gjeneron atë për bankën, është përgjegjëse për hedhjen e saj në BED në një kohë sa më të shpejtë. Për shembull, Njësia e Mbikëqyrjes dhe Analizës nga Jashtë, është përgjegjëse për të hedhur në BED produktet e saj, ndërkohë që korrespondenca me bankën mund të hidhet në BED nga ana e inspektorit që mbulon bankën. Në rast paqartësie si edhe për të siguruar hedhjen e informacionit në kohën e duhur, drejtuesit e departamentit përcaktojnë njësinë përgjegjëse (ose punonjësin) për hedhjen e të dhënave në

BED.

BED, përfaqëson një zonë të mbyllur informacioni, ku e drejta për të hyrë dhe për të hedhur informacioni i takon vetëm Departamentit të Mbikëqyrjes. E drejta e shfrytëzimit të informacionit, mund t'i jepet edhe administratorëve të Bankës së Shqipërisë, mbështetur në nevojën për një gjë të tillë.

Në bashkëpunim me Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, përcaktohen kërkesat për ruajtjen e BED, për mënyrën e përdorimit të saj dhe identifikimin e çdo përdoruesi.

III. KOMUNIKIMI

a) Komunikimi brenda Departamentit të Mbikëqyrjes

Në përgjithësi, të gjitha njësitë përbërëse të Departamentit të Mbikëqyrjes duhet ta ndajnë mes tyre informacionin që shërben për qëllime të aktivitetit mbikëqyrës, në kohë reale. Nëse bihet në kontakt me një informacion që konsiderohet si "konfidencial", ky i bëhet i ditur fillimisht drejtuesve të departamentit, të cilët më pas vendosin për shpërndarjen e tij në departament.

Produktet e secilës njësi të Departamentit Mbikëqyrës, janë të aksesueshme nga çdo njësi tjetër e departamentit.

Materialet dhe produktet që realizohen në Departamentin e Mbikëqyrjes, duhet t'i nënshtrohen një procesi komunikimi, diskutimi dhe shkëmbimi opinionesh gjatë fazës së përgatitjes së tyre. Ky proces integrimi duhet të synohet të jetë i dokumentuar, pra në formë të shkruar.

Vendimmarrja në Departamentin e Mbikëqyrjes është e drejtë dhe përgjegjësi e drejtuesve të departamentit. Megjithatë në çdo rast, bëhen përpjekjet maksimale për të zgjeruar bazën e vendimmarrjes nëpërmjet marrjes së mendimeve paraprake dhe diskutimit të çështjeve konkrete, si një mënyrë e cila siguron kuptimin më të mirë të vendimeve që do të merren dhe që rrit qëndrueshmërinë e tyre.

Në rastin kur informacioni që shpërndahet ka një rëndësi më të madhe (të veçantë) për një punonjës ose një njësi të caktuar të Departamentit të Mbikëqyrjes, kjo theksohet në momentin e shpërndarjes së informacionit duke tërhequr vëmendjen edhe mbi problemin kryesor që ai trajton.

Dhënia e mendimeve për informacionin ose materialet që qarkullojnë në Departamentin e Mbikëqyrjes, veçanërisht kur kjo gjë kërkohet nga punonjësi ose njësi dërguese, është një detyrim i hallkave të tjera të Departamentit të Mbikëqyrjes.

b) Komunikimi me njësitë e tjera të Bankës së Shqipërisë

Komunikimi i Departamentit të Mbikëqyrjes, me njësitë e tjera brenda Bankës së Shqipërisë, do të jetë një tipar i qënësishëm i departamentit. Ky komunikim do të ndërtohet mbi këto parime:

- detyrimin për të raportuar përpara Administratorëve dhe Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, në formën dhe mënyrën e përcaktuar, për punën e kryer si edhe për të mbështetur vendimmarrjen;
- ruajtjen e informacionit i cili konsiderohet si “konfidencial”, veçanërisht kur marrja e tij është bërë në mirëbesim dhe shpërndarja nuk është autorizuar nga dhënësi i informacionit si edhe kur shpërndarja e tij mund të ketë pasoja negative në aktivitetin e një banke ose për marrëdhëniet e saj me Bankën e Shqipërisë;
- sigurimin e informacionit të nevojshëm për qëllime të aktivitetit mbikëqyrës;
- rritjen e transparencës për punën e kryer në Departamentin e Mbikëqyrjes;
- dhënien e informacionit i cili nuk lidhet vetëm me Departamentin e Mbikëqyrjes por edhe me njësi të tjera të Bankës së Shqipërisë;
- marrjen/dhënien e mendimeve për materiale të ndryshme të departamentit të Mbikëqyrjes ose të njësive të tjera të Bankës së Shqipërisë;
- shkëmbimin e përvojës për probleme të ndryshme, në formën e bashkëpunimeve në grupe pun të përbashkëta, seminare, takime diskutimi etj..

Komunikimi duhet të jetë i vazhdueshëm, për çështje të rëndësishme dhe konkrete, si edhe me rezultatet të matshme.

Secila njësi e Departamentit të Mbikëqyrjes, mund të komunikojë direkt me çdo njësi tjetër brenda Bankës së Shqipërisë, duke patur në konsideratë parimet e mësipërme dhe duke vënë gjithmonë në dijeni me shkrim, drejtuesit e Departamentit të Mbikëqyrjes.

ç) Komunikimi jashtë Bankës së Shqipërisë

Krahas bankave dhe institucioneve të tjera që mbikëqyr, Departamenti i Mbikëqyrjes komunikon edhe me institucione të tjera dhe individë, duke vendosur në qendër të këtij komunikimi çështje të aktivitetit mbikëqyrës. Parimet mbi të cilat ndërtohet ky komunikim janë:

- ruajtja e informacionit i cili konsiderohet si “konfidencial”, veçanërisht kur marrja e tij është bërë në mirëbesim dhe shpërndarja nuk është autorizuar nga dhënësi i informacionit si edhe kur shpërndarja e tij mund të ketë pasoja negative në aktivitetin e një banke, në marrëdhëniet e saj me Bankën e Shqipërisë, në marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me të tretët;
- saktësimi, nëse ky informacion duhet të dalë nga Departamenti i Mbikëqyrjes, nga departamente të tjera apo nga administratorët e Bankës së

Shqipërisë;

- detyrimi për të dhënë përgjigje lidhur me praktika të mbikëqyrjes;
- detyrimi për të bërë transparent aktivitetin dhe rezultatet e Departamentit të Mbikëqyrjes;
- nevoja për informacion nga institucione të tjera;
- publikimi i vendimeve të mbikëqyrjes, të cilat ndikojnë institucione të tjera;
- dhënia e mendimeve dhe e vlerësimeve për çështje të ndryshme që bashkojnë veprimtarinë e mbikëqyrjes me atë të institucioneve të tjera;
- respektimi i marrëveshjeve në drejtim të shkëmbimit të informacionit me institucione të tjera me funksione mbikëqyrëse brënda dhe jashtë vendit.

Komunikimi duhet të jetë i vazhdueshëm, për çështje të rëndësishme dhe konkrete, si edhe me rezultate të matshme.

Rëndësi të veçantë në komunikimin me institucione jashtë Bankës së Shqipërisë, merr komunikimi me auditorët e jashtëm të bankave. Qëllimi i këtij komunikimi është vendosja e një bashkëpunimi konkret dhe të vazhdueshëm në raportin që të dy institucionet kanë ndaj bankave të nivelit të dytë. Ruajtja e integritetit të secilit institucion, shkëmbimi i përvojës në drejtime me interes të dyanshëm dhe respektimi i standardeve më të mira që përcaktojnë këto marrëdhënie, do të jenë parimet kryesore që do të përcaktojnë këtë bashkëpunim.

Komunikimi me shkrim në emër të Departamentit të Mbikëqyrjes, realizohet vetëm nga drejtuesit e Departamentit të Mbikëqyrjes ose nga administratorët e Bankës së Shqipërisë.

Aneks 1 : Shpjegim i shkurtër mbi CAMELS

Gjatë inspektimit në vend të një banke, mbikëqyrësit mbledhin informacion mbi bazën e të cilit vlerësojnë gjendjen financiare si edhe monitorojnë përputhshmërinë me ligjin dhe kuadrin rregullator. Një produkt i rëndësishëm i këtij inspektimi, është një renditje (nga këndvështrimi mbikëqyrës) i gjendjes së përgjithshme të bankës, referuar si renditja sipas CAMELS. Tre institucionet mbikëqyrëse më të njohura që përdorin këtë sistem renditjeje janë Rezerva Federale (FRB), Korporata e Sigurimit të Depozitave Financiare (FDIC) dhe Zyra e Kontrollit të Monedhes (OCC), të gjitha në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Akronimi CAMEL, i referohet pesë përbërësve të gjendjes së bankës të cilët vlerësohen dhe konkretisht: mjaftueshmëria e kapitalit (Capital adequacy), cilësia e aktiveve (Asset quality), administrimi (Management), të ardhurat (Earnings) dhe likuiditeti (Liquidity). Përbërësi i gjashtë, ndjeshmëria e bankës ndaj rrezikut të tregut (Sensitivity to market risk) u shtua në vitin 1997, duke e ndryshuar këtë akronim në CAMELS. Cdo përbërës renditet, krahas renditjes që i bëhet gjendjes së përgjithshme financiare të bankës. Renditja kryhet në një shkallë nga 1 në 5. Bankat me një renditje 1 ose 2, konsiderohen që paraqesin aspak ose pak probleme mbikëqyrëse, ndërsa bankat që renditen 3, 4 ose 5 paraqesin probleme mbikëqyrëse të moderuara dhe deri në një problematikë shumë të vështirë (ekstreme).

Cdo material i inspektimit, duke përfshirë edhe renditjen sipas CAMELS është konfidencial. Ai njihet drejtpërsëdrejti vetëm nga drejtuesit kryesorë të bankës dhe nga personeli i duhur i autoritetit mbikëqyrës.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr.31, datë .28 04. 2004

Për

“Emërimin e Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë”

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Juridik, në bazë të nenit 43, shkronja“h” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të emërohet zoti Zihni Djepaxhia në detyrën e Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë.
2. Marrëdhëniet e punës të zotit Zihni Djepaxhia në detyrën e Drejtorit të Departamentit të Emisionit, fillojnë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI
Ylli MEMISHA**

**KRYETARI
Shkëlqim CANI**

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 1, Janar 2004

1. Vendim nr. 01, datë 28. 01. 2004. Për miratimin e “Raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2003”
2. Vendim nr.02, datë 28.01. 2004. Për “Miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare -AIPS” .
3. Vendim nr.03, datë 28.01.2004. Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të thesarit (ATM)” miratuar me vendimin nr. 75, datë 25.09. 2002.
4. Vendim nr.04, datë 28.01.2004. Për një ndryshim në rregulloren “Mbi funksionimin e shërbimit të sistemit SWIFT” miratuar me vendimin nr. 16, datë 01.03. 2000.
5. Vendim nr.05, datë 28.01. 2004. Për miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullore “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 2, Shkurt 2004

1. Vendim nr. 06, datë 11.02. 2004. Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, të “Bankës Popullore” Sh.a.
2. Vendim nr. 07, datë 11.02. 2004. Për “Përcaktimin e pagës bazë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë” .

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 3, Shkurt 2004

1. Vendim nr. 08, datë 25.02.2004. Për miratimin e “Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2004”
2. Vendim nr.09, datë 25.02.2004. Për miratimin e deklaratës të Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimet e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”
3. Vendim nr. 10, datë 25.02.2004. Për miratimin e rregullore “Për parandalimin e pastrimit të parave”.
4. Vendim nr.11, datë 25.02.2004 Për miratimin e udhëzimit “Mbi procedurat e nxjerrjes së urdhërzhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë”.

5. Vendim nr. 12, datë 25. 02. 2004. "Për miratimin e bilancit dhe për përdorimin e fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003".
6. Vendim nr.13, datë 25.02.2004. Për "Pezullimin dhe ndalimin e kryerjes së disa veprimtarive të përfshira në aneksin e licencës së Bankës Italo-Shqiptare".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 4, Mars 2004

1. Vendim nr. 16, datë 10.03.2004. Për "Miratimin e fondit numizmatik të monedhave metalike e të kartëmonedhave shqiptare".
2. Vendim nr. 17, datë 10. 03. 2004. "Për miratimin e disa ndryshimeve në Sistemin Raportues të Unifikuar".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 5, Mars 2004

1. Vendim nr. 20, datë 24.03.2004. Për miratimin e rregullores "Mbi kredinë brenda ditës".
2. Vendim nr.21, datë 24.03.2004. "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës" miratuar me vendimin nr. 57, datë 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr. 40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".
3. Vendim nr.22, datë 24.03.2004. Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit".
4. Vendim nr.23, datë 24.03.2004. Për "Lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 5, Mars 2004

1. Vendim nr. 26, datë 14. 04. 2004. Për lejimin e ushtrimit të aktivitetit kredidhënës nga Banka e Kursimeve
2. Vendim nr. 27 datë 14. 04. 2004. "Për miratimin e transferimit të pronësisë së 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank".